



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 28 tetor 2019
Nr.re.:RK 1458/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI88/18

Parashtrues

Hysnije Dedinca

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit Rev. nr. 124/2018 të
Gjykatës Supreme të 12 prillit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama –Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Hysnije Dedinca, (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës) nga fshati Vragoli, komuna e Fushë Kosovës, të cilën e përfaqëson Jeton Osmani, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 124/2018 të 12prillit 2018, me të cilin është refuzuar si e pasafatshme kërkesa e parashtrueses për revizion, e parashtruar ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Ac. nr. 547/2008 të 18 marsit 2009.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtrueses së kërkesës të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 28 qershor 2018, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 16 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
7. Më 7 shtator 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 9 nëntor 2018, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë të dorëzojë një kopje të vërtetimit për pranimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Ac. nr. 547/2008 të 18 marsit 2009 nga ana e parashtrueses së kërkesës.
9. Më 16 nëntor 2018, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë vërtetimin për dorëzimin e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut parashtrueses së kërkesës me datën e dorëzimit të 5 majit 2009.
10. Më 8 tetor 2019, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarës raportuese, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 14 nëntor 2006, parashtruesja e kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër Korporatës Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KEK) lidhur me kompensimin e përkohshëm të pagave për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës së bashkëshortit të saj të ndjerë.
12. Më 16 gusht 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktgjykimin C1. nr. 400/2006 e aprovoi padinë e parashtrueses së kërkesës dhe e obligoi KEK-un që parashtrueses së kërkesës, *“në emër të kompensimit të përkohshëm të pagës të paraparë me Marrëveshjen e lidhur në mes të tani të ndjerit Hajdin Dedinca (bashkëshort i paditëses) dhe të paditurës, nr. 2897 të 15.08.2001 – për kohën nga 01.09.2006 deri më dt. 31.07.2007, t’ia paguajë shumën prej 1.335€-në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së Aktgjykimit, nën kanosjen e përmbarimit me dhunë, kurse që nga dt. 01.06.2007 e derisa të përmbushen kushtet a parapara me Marrëveshjen e cekur t’ia paguajë nga 105 € për çdo muaj”*.
13. Më 22 tetor 2007, KEK-u ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë për shkak të *“shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale”*.
14. Më 18 mars 2009, Gjykata e Qarkut me Aktgjykimin Ac. nr. 597/2008 aprovoi si të bazuar ankesën e KEK-ut dhe në pajtim me këtë, e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 400/2006, të 16.08.2007 ashtu që *“refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses Hysnije Dedinca nga fshati Vragoli, Komuna e Fushë-Kosovës, për detyrimin e paditëses për kompensimin e përkohshëm të pagës sipas Marrëveshjes[...]”*.
15. Në bazë të kopjes së bashkangjitur të vërtetimit për dorëzimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Ac. nr. 597/2008 parashtrueses së kërkesës, rrjedh se aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 5 maj 2009.
16. Më 12 mars 2018, parashtruesja e kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, sepse *“ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe si pasojë e zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, ka sjellë Aktgjykim të kundërligjshëm.”*
17. Më 12 prill 2018, Gjykata Supreme me Aktvendimin Rev. nr. 124/2018 e hodhi poshtë si të pasafatshëm revizionin e parashtrueses së kërkesës. Në arsyetim, Gjykata Supreme thekson: *“Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se paditësja revizionin në gjykatë e ka dorëzuar pas afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh të përcaktuar sipas dispozitës së nenit 2 1.1 të LPK-së, nga se, nga fletëkthesa që gjendet në shkresat e lëndës del se paditësja aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë e ka pranuar me datë 4.05.2009, afati për paraqitjen e revizionit ka filluar të rrjedhë nga dita e nesërme më 05.05.2009, dhe dita e fundit për*

ushtrimin e revizionit ka qenë 04.06.2009 (e premte). Paditësja revizionin e ka paraqitur pas 8 vjet e 3 muajve, që do të thotë pas afatit të përcaktuar me dispozitën e nenit 211.1 të LPK-së”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme asaj i është shkelur drejta e barazisë para ligjit, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe e drejta për mjet efektiv juridik, të drejta të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
19. Parashtruesja e kërkesës më tej pretendon se, *“konstatimi i Gjykatës Supreme se Revizioni i paraqitur është i pas afatshëm është i pabazuar i papranueshëm dhe rrjedhimisht i kundërligjshëm, madje edhe bie ndesh me nenin 6 të Konventës Evropiane. Kjo pikërisht për arsye, se mos dorëzimi Aktgjykimit Ac. nr. 597/2008 të dt 18.03.2009 në formën e paraparë ligjore konsiston në atë se pala paditëse nuk është trajtuar si duhet dhe në mënyrë të barabartë në këtë procedurë”.*
20. Në thelb, parashtruesja e kërkesës të gjitha shkeljet e pretenduara, i mbështet me pretendimin se gjykatat e rregullta, *“nuk kanë vepruar konform dispozitave ligjore të cilat rregullojnë çështjen e dorëzimit personal të shkresave, konkretisht dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore (...)”.*Në bazë të pretendimit të parashtrueses së kërkesës, mos dorëzimi i aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut sipas dispozitave ligjore rezultoi që revizioni i saj të shpallet i pasafatshëm, dhe si rrjedhojë i ishte pamundësuar që të marrë përgjigje përfundimtare nga gjykatat lidhur me rastin e saj, dhe në këtë mënyrë i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
21. Parashtruesja kërkon nga Gjykata që:

“I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të drejtave të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejte dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] në lidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektiv) të KEDNJ-së dhe nenin 102 par. 5 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës;

III. TË KONSTATOJË se Revizioni i datës 12.03.2018 i parashtrueses së kërkesës - paditëses i paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 597/2008 i 18.03.2009, është i afatshëm;

IV. TA SHPALLË të pavlefshëm Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 124/2018 të 12 prillit 2018;

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara më tej me Ligj dhe të precizuara më tej me Rregulloren e Punës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

24. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kushtet e pranueshmërinë të cilat janë të përcaktuara më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata thirret në nenet 47[Kërkesa Individuale], 48[Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa Individuale]

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

25. Sa i përket përmbushjes së kushteve të lartpërmendura, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar; i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion; e ka cekur aktin e organit publik të cilin e konteston para Gjykatës dhe e ka dorëzuar kërkesën me kohë.

26. Përveç kësaj, Gjykata thirret në rregullin 39(2) [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së Punës e cili parasheh:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi i kërkesës nuk e ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

27. Gjykata vëren, para së gjithash, se parashtruesja e kërkesës pretendon shkeljen e një numri të neneve të Kushtetutës, por arsyeton vetëm shkeljen e neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, që sipas pretendimeve të parashtrueses së kërkesës u shkel për dy arsye, edhe atë: **a)** konstatimi i Gjykatës Supreme se revizioni ishte parashtruar jashtë afatit ishte i pabazuar dhe i papranueshëm dhe, si rezultat i kësaj, ishte i paligjshëm; **b)** se gjykatat e rregullta nuk kanë vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë çështjen e dorëzimit personal të shkresave, konkretisht sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

28. Më tej, parashtruesja e kërkesës nuk e arsyeton shkeljen e neneve të tjera të Kushtetutës, por i ndërlidh ato me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, dhe pretendon se nenet 3, 54, dhe 102, të Kushtetutës si dhe neni 13 i KEDNJ-së, janë shkelur në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

a) Shkeljet e pretenduara të nenit 31 dhe 32 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me konstatimin e Gjykatës Supreme se revizioni është paraqitur jashtë afatit

29. Në lidhje me këto pretendime të parashtrueses së kërkesës, Gjykata vëren se, në bazë të kopjes së bashkëngjitur të vërtetimit mbi dorëzimin e Aktgjykimit Ac. nr. 597/2008 të Gjykatës së Qarkut rrjedh se aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut i ishte dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 5 maj 2009.

30. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesja e kërkesës, më 12 mars 2018, kishte parashtruar në Gjykatën Supreme kërkesën për revizion ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut.

31. Gjykata rikujton, se Gjykata Supreme e hodhi poshtë kërkesën për revizion të parashtrueses së kërkesës për arsye thjesht procedurale, sepse ishte parashtruar jashtë afatit kohor, duke konstatuar se nuk ishte parashtruar siç parashihet me nenet përkatëse të LPK-së dhe, rrjedhimisht, Gjykata Supreme nuk është marrë konkretisht me thelbin e kërkesës së parashtrueses.

32. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se Gjykata Supreme i kishte shpjeguar hollësisht parashtrueses së kërkesës se ajo kishte pasur detyrim ligjor që të ushtrojë revizion brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh. Gjykata vëren se sipas LPK-së, parashtruesja e kërkesës ka pasur mundësinë të paraqesë arsyetimin për lëshimin e afatit kohor në kërkesën për përsëritjen e procedurës.
33. Në lidhje me këtë, Gjykata konkludon se parashtruesja e kërkesës nuk i ofroi Gjykatës dëshmi *“se paditësja nuk ishte trajtuar si duhet dhe në mënyrë të barabartë në procedurën aktuale”* dhe se, në pajtim me këtë, Gjykata konsideron se deklaratimet e saj në lidhje me këto pretendime janë qartazi të pabazuara në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së Punës.

b) Shkeljet e pretenduara të nenit 31 dhe 32 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me dispozitat ligjore që rregullojnë çështjen e dorëzimit personal të shkresave

34. Në lidhje me këtë pretendim të parashtrueses së kërkesës, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës në thelb kundërshton zbatimin e ligjit në fuqi nga gjykatat e rregullta dhe mënyrën në të cilën ishte dorëzuar aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut.
35. Gjykata rithekson që Gjykata Themelore ia ka dorëzuar Gjykatës vërtetimin mbi dorëzimin e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, parashtrueses së kërkesës me datë të dorëzimit të 5 majit 2009.
36. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton vendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, e cila thekson:

“Paditësja e ka paraqitur revizionin pas 8 vjet e 3 muajve, që do të thotë pas afatit të përcaktuar me dispozitën e nenit 211.1 të LPK-së.”

37. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet në fakte ose të ligjit (ligjshmërisë), të cilat pretendohet se janë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Gjykata Kushtetuese nuk mund të vlerësojë ligjin që çoi në marrjen nga gjykatat e rregullta të një vendimi në vend të ndonjë vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosura në juridiksionin e saj. Në fakt, është roli i gjykatave të rregullta për të interpretuar dhe zbatuar rregullat përkatëse të ligjit procedural dhe material (shih rastin e GJEDNJ-së, *Perlala kundër Greqisë*, nr. 17721/04, të 22 majit 2007, par. 25).
38. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se arsyetimi i dhënë nga Gjykata Supreme me rastin e vendosjes në lidhje me kërkesat e parashtrueses së kërkesës është i qartë, gjithëpërfshirës dhe koherent dhe se procedurat para gjykatave të rregullta nuk ishin të padrejta ose arbitrare (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 30 qershorit 2009; *Shub kundër Lituanisë*, nr 17064/06).

39. Prandaj, Gjykata konkludon se parashtruesja e kërkesës nuk i mbështeti pretendimet e saj se procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të paligjshme ose arbitrare dhe se vendimet e kontestuara shkelin të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
40. Gjykata, më tej, vëren se parashtruesja e kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurave para gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtrueses së kërkesës me rezultatin e procedurave nga ana gjykatave të rregullta nuk mund të shërbej në vetvete si e drejtë për të ngritur një pretendim për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur – Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Kërkesa nr. 5503/02, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
41. Bazuar në arsyet e mësipërme, Gjykata konkludon se faktet e paraqitura nga parashtruesja e kërkesës nuk i arsyetojnë në asnjë mënyrë pretendimet e saj për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë.
42. Prandaj, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtrueses së kërkesës është qartazi e pabazuar mbi baza kushtetuese dhe, rrjedhimisht, është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës në pajtim me nenin 113. 1 dhe 7 të Kushtetutës, dhe rregullin 39.(2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 8 tetor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selvetë Gërxhalli-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi